



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE “BEQIR ÇELA” DURRES

Nr. 508 Prot.

Durrës, më 18.09.2026

Lënda : Njoftim vend vakant

Drejtuar: Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore,
Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun,
Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; të udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë, menaxhimin e burimëve njerëzore, zhvillimin e vazhduar profesional të personelit, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional” I ndryshuar.

Ofruesi publik I AFP-së, Shkolla profesionale “Beqir Çela”, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

1. Instruktur të praktikës profesionale në drejtimin Elektroteknikë – 1 (një) mësues.

1 - Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Kriteret e përgjithshme:

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit publik të arsimit dhe formimit profesional duhet të përmbushë këto kriteret:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Kritere të posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për instruktor të praktikës profesionale:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së. .
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2- Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

✓ *Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.*

✓ *Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.*

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda datës 30.09.2026.

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar.

DREJTOR

Fatmir Merkuri

